

TRANZIT Sh.p.k

**Pasqyrat Financiare të veçanta
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(me raportin e audituesit të pavarur
bashkëngjitur)**

PËRMBAJTJA

Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar	1
Pasqyra e veçantë e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyrave e veçantë e flukseve monetare	4
1. Njësia raportuese	5
2. Baza kontabël	5
3. Ndryshimet në politikat kontabël	6
4. Politikat e rëndësishme kontabël	8
5. Administrimi i rrezikut financiar	21
6. Përdorimi i vlerësimit dhe gjykimit profesional	27
7. Shënimet mbi vlerën e drejtë	28
8. Analiza e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit sipas maturitetit të mbetur	29
9. Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	30
10. Aktivet financiare me kosto të amortizuara	30
11. Aktive të tjera	31
12. Investime në filial	31
13. E drejta e përdorimit të aktivit dhe detyrimi i qirasë.....	32
14. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	33
15. Aktive të qëndrueshme të partupëzuara	34
16. Detyrime ndaj personelit	34
17. Detyrime të tjera	34
18. Kapitali i paguar	35
19. Të ardhura nga interesi	35
20. Shpenzime interesi	35
21. Të ardhura nga kontrata me klientë	36
22. Shpenzime personeli	36
23. Shpenzime administrative	36
24. Tatimi mbi fitimin	36
25. Transaksione me palë të lidhura.....	38
26. Angazhime dhe detyrime.....	38
27. Çështje gjyqësore	39
28. Ngjarje pas datës së raportimit.....	39

Rruga e Kavajës,
Ndërtesa Nr. #27,
H1, kati i 3-të
Tirane

12 korrik 2023

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Ortakët e "TRANZIT SH.P.K."

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të "Tranzit sh.p.k." (më tej referuar si "Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2022, pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e veçantë të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e veçantë të flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat e veçanta financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2022, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standarde të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare individuale ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Shoqërisë të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare individuale përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilat janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tirana, Albania

12 korrik 2023



Tranzit sh.p.k

PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktivitet			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	9	92,714,028	150,331,329
Aktive financiare me kosto të amortizuar	10	142,491,723	127,476,634
Tatim fitimi i parapaguar	24	1,095,440	3,639,684
Aktive të tjera	11	5,141,960	11,843,100
Investime në filial	12	79,845,000	69,845,000
E drejta e përdorimit të aktiveve	13	31,706,358	37,743,015
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	14	8,130,769	9,273,456
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	15	3,479,803	4,644,686
Totali i aktiveve		364,605,081	414,796,904
Detyrimet			
Detyrime ndaj personelit	16	1,727,694	1,886,947
Detyrime të tjera	17	6,183,164	55,151,044
Llogari të pagueshme		10,464,110	12,244,306
Detyrime ndaj qirave	13	33,447,535	39,093,395
Totali i detyrimeve		51,822,503	108,375,692
Kapitali aksionar			
Kapitali i paguar	18	177,291,572	177,291,572
Fitime të akumuluar		(770,224,255)	(620,646,107)
Fitimi i vitit		905,715,262	749,775,747
Totali i kapitalit aksionar		312,782,579	306,421,212
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		364,605,081	414,796,904

Shënimet nga faqja 5 deri në 39 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

Tranzit sh.p.k

PASQYRA E VEÇANTË E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Të ardhura nga interesi	19	215,654,918	143,534,021
Shpenzime interesi	20	(2,118,752)	(1,435,526)
Të ardhura neto nga interesi		213,536,166	142,098,495
Të ardhura nga shërbimet ndaj palëve të treta	21	70,362,854	60,161,702
Fitim/(Humbja) nga kurset e këmbimit		(1,973,790)	(674,045)
Të ardhura nga dividend	18	835,000,000	685,000,000
Të ardhura të tjera		903,389,064	744,487,657
Provizjon për humbjet nga kreditë	10	(44,132,173)	17,753,151
Zhvlerësimi dhe amortizimi	13,14,15	(9,351,199)	(10,654,475)
Shpenzime personeli	22	(78,528,530)	(97,182,486)
Shpenzime operative	23	(65,018,365)	(33,878,154)
		(197,030,267)	(123,961,964)
Fitimi para tatimit		919,894,963	762,624,188
Tatimi mbi fitimin	24	(14,179,701)	(12,848,441)
Fitimi për vitin		905,715,262	749,775,747
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		905,715,262	749,775,747

Këto pasqyra financiare të veçanta u miratuan nga Drejtimi i "TRANZIT SH.P.K.", më 30 mars 2023 dhe janë nënshkruar nga:


Kristina Naumi
Administrator




Armand Muharemi
Drejtor Finance

Shënimet nga faqja 5 deri në 39 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të veçanta.

Tranzit sh.p.k

PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

	Kapitali i paguar	Fitime të akumuluar	Kapitali gjithsej
Gjendja më 1 janar 2021	177,291,572	133,804,756	311,096,328
Fitimi i periudhës	-	749,775,747	749,775,747
Dividend i shpërndarë	-	(754,450,863)	(754,450,863)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	177,291,572	129,129,640	306,421,212
Fitimi i periudhës	-	905,715,262	905,715,262
Dividend i shpërndarë	-	(899,353,895)	(899,353,895)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	177,291,572	135,491,007	312,782,579

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet bashkërisht me shënimet dhe pjesët përbërëse të pasqyrave të veçanta nga faqja 5 deri në 39.

Tranzit sh.p.k

PASQYRAVE E VEÇANTË E FLUKSEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Flukset e parasë nga aktivitetet operacionale			
Fitime përpara tatimit		919,894,963	762,624,188
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlrësimi dhe amortizimi	18, 19, 20	9,351,199	10,654,475
Të ardhura nga dividend i filialit	22	(835,000,000)	(685,000,000)
Zhvlrësimi i aktiveve financiare	16	94,883,015	44,747,702
Flukset e parasë nga aktivitetet operacionale para ndryshimeve në kapitalin punues			
		189,129,177	133,026,365
Ndryshimi i dividendit të pagueshëm	22	-	(59,362,813)
Ndryshimi në aktive financiare me kosto të amortizuar	16	(109,898,104)	(120,097,577)
Ndryshimi në aktive të tjera		9,245,384	(11,494,098)
Ndryshimi në detyrime të tjera		(51,511,095)	66,630,658
Ndryshimi në llogari të pagueshme		(1,780,197)	4,061,047
Interes i paguar	10	2,118,752	1,435,526
Tatim fitimi i paguar	14	(14,179,701)	(12,848,441)
Mjete monetare nga aktivitetet operacionale, neto			
		23,124,216	1,350,664
Flukset e parasë të përdorura në aktivitetet investuese			
Dividend i arkëtuar	22	835,000,000	685,000,000
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	19	(1,006,972)	(901,284)
Investime ne filiale		(10,000,000)	-
Mjete monetare të përdorura nga aktivitetet investuese, neto			
		823,993,028	684,098,717
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese			
Dividend i papaguar	22	(899,353,895)	(754,450,863)
Ripagim i detyrimeve të qirasë		(5,380,649)	(7,411,914)
Mjete monetare nga aktivitetet financuese, neto			
		(904,734,544)	(761,862,777)
Rritja/(Rënia) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve gjatë vitit		(57,617,300)	(76,413,394)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në 1 janar	15	150,331,329	226,744,723
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në 31 dhjetor	15	92,714,028	150,331,329

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri më 39, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

1. NJËSIA RAPORTUESE

TRANZIT SH.P.K. ("Shoqëria") është një institucion financiar jo-bankë, i autorizuar nga Banka e Shqipërisë sipas licencës me Nr. 20, datë 04.08.2010, për ushtrimin e veprimtarisë së kredidhënies, faktoringut, qirasë financiare, shërbimeve këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbimeve të tjera ndihmëse. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Shoqëria është përqendruar në krijimin e mundësive financiare të përshtatura për nevojat e shoqërive dhe individëve. Produktet financiare që ofrohen përfshijnë kreditë dhe linjat e kredive të zakonshme, kredi të kombinuara me paketë në aksione të shoqërisë kredimarrëse, pjesëmarrje në kapital, blerje borxhi si dhe shërbime të mbledhjes së borxheve, si pjesë e strategjisë së saj për mbledhjen e informacionit mbi portofolet e kredisë të cilat synohen të blihen.

Më 31 dhjetor 2022, kapitali i Shoqërisë është 177,291,572 Lekë, i ndarë në katër kuota midis ortakëve si më poshtë:

- MOSCOPOLE INC - Ortak, i cili zotëron 80% të kapitalit me vlerë 141,833,257.60 Lekë;
- New Century Holdings XI, L.P., - Ortak, i cili zotëron 10% të kapitalit me vlerë 17,729,157.20 Lekë;
- NCH Balkan Fund, L.P., - Ortak, i cili zotëron 10% të kapitalit me vlerë 17,729,157.20 Lekë.

Zyra e regjistruar e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga e Kavajës, Ndërtesa Nr. #27, H1, kati i 3-të. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në zyrat qendrore në Tiranë. Më 31 dhjetor 2022, Shoqëria kishte 45 punonjës (2021: 49 punonjës).

2. BAZA KONTABËL

a) Deklaratë e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të veçanta të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"), me përjashtim të konsolidimit të shoqërive të kontrolluara. Gjithashtu, Shoqëria përgatit pasqyrave financiare të konsoliduara, për të njëjtën periudhë raportuese, duke përfshirë pozicionin dhe rezultatit financiar të "Banka Amerikane e Investimeve sh.a.", "ABI Broker sh.a." dhe "ABI Invest sh.a.".

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të veçanta janë përgatitur bazuar në koston historike.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të veçanta janë përgatitur në Lekë, e cila është monedha funksionale për Shoqërinë. Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, informacioni financiar është i prezantuar në Lekë.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare të veçanta kërkon nga drejtimi për të bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që prekin zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe supozimet bazë shqyrtohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë të cilës është rishikuar vlerësimi dhe në çdo periudhë të ardhshme që preket.

Në veçanti, informacioni lidhur me fusha të rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave kontabël, që kanë efektin më të rëndësishëm tek shuma e konstatuar në pasqyrat financiare, përshkruhen në Shënimin 4. Politikat kontabël të paraqitura në vazhdim, janë aplikuar në mënyrë konsistente përsa u përket periudhave të prezantuara në këto pasqyra financiare të veçanta.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

2. BAZA KONTABËL (VAZHDIM)

e) Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të parimit të vijueshmërisë, i cili supozon që Shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë e saj operacionale për të paktën një periudhë prej 12 muajsh nga data e raportimit financiar.

Drejtimi i Shoqërisë ka arritur në përfundim se nuk ka pasiguri të qenësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vijuar aktivitetin e saj, për të ardhmen e parashikueshme, prej të paktën 12 muajsh nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, Drejtimi gjykon se parimi i vijueshmërisë është bazë e përshtatshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave.

3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL

a) Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022

Disa standarde të kontabilitetit të cilat janë bërë efektive nga 1 janari 2022 dhe që janë miratuar nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare ose pozicionin e Shoqërisë. Për këtë arsye informacioni shpjegues lidhur me këto Standarde nuk është dhënë në pasqyrat e Shoqërisë.

b) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde të reja, por ende jo detyruesisht efektive, Standarde dhe Ndryshime në Standardet ekzistuese, dhe Interpretime janë botuar nga BSNK. Standardet dhe ndryshimet që nuk janë akoma efektive dhe nuk janë miratuar në fillim nga Shoqëria përfshijnë:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve - efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023
- Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Klasifikimi i detyrimeve si korente ose afatgjata (Ndryshimet në SNK 1).
- Dhënia e informacioneve shpjeguese për politikat kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNRF 2 Deklarata e Praktikës).
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 1).

Këto standarde ose ndryshimet në standardet ekzistuese nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria. Drejtimi parashikon që të gjitha prononcimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e reja që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë paraqitur pasi ato nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (në fuqi më ose pas 1 janarit 2023)

SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (d.m.th., sigurimi i jetës, jo-jetës, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe ri-sigurimi), pavarësisht nga lloji i njërive ekonomike që i lëshojnë ato, si dhe për disa garanci dhe instrumente financiarë me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionale.

SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimit, duke mbuluar të gjitha aspektet përkatëse të kontabilitetit. Thelbi i SNRF 17 është modeli i përgjithshëm, i plotësuar nga:

- Një përshtatje specifike për kontratat me tipare të pjesëmarrjes direkte (qasja e tarifës së ndryshueshme)
- Një qasje e thjeshtuar (qasja e alokimit të primit) kryesisht për kontratat me kohëzgjatje të shkurtër

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

b) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria (vazhdim)

SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (në fuqi më ose pas 1 janarit 2023) (vazhdim)

Matja e vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme, duke përfshirë një rregullim të qartë të rrezikut, e rimatur çdo periudhë raportuese (përbushja e flukseve monetare). Një Marzh të Kontraktuar të Shërbimit (CSM) të barabartë dhe të kundërt me çdo fitimi të ditës së parë në flukseve monetare për realizimin të një grupi kontratash, që përfaqëson fitimin e pafitur të kontratave të sigurimit që do të njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës së shërbimit (d.m.th., periudha e mbulimit). Ndryshime të caktuara në vlerën aktuale të pritshme të flukseve të ardhshme të parasë rregullohen kundrejt CSM dhe në këtë mënyrë njihen në fitim ose humbje gjatë periudhës së mbetur të shërbimit kontraktual.

Ndryshimet në SNK 1: Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-korente, efektive më ose pas 1 janarit 2022

E drejta për të shtyrë shlyerjen

Nëse e drejta e një njësie ekonomike për të shtyrë shlyerjen e një detyrimi i nënshtrohet njësisë ekonomike në përputhje me kushtet e specifikuara, njësia ekonomike ka të drejtë të shtyjë shlyerjen e detyrimit në fund të periudhës së raportimit nëse është në përputhje me ato kushte në atë datë.

Ekzistenca në fund të periudhës raportuese

Ndryshimet sqarojnë gjithashtu se kërkesa për të drejtën për të ekzistuar në fund të periudhës së raportimit zbatohet pavarësisht nëse huadhënësi teston për pajtueshmëri në atë datë apo në një datë të mëvonshme.

Pritjet e menaxhimit

SNK 1.75A është shtuar për të sqaruar se 'klasifikimi i një detyrimi nuk preket nga gjasat që njësia ekonomike të ushtrojë të drejtën e saj për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit'. Kjo është, qëllimi i drejtimit për t'u vendosur në një periudhë afatshkurtër nuk ndikon në klasifikim. Kjo vlen edhe nëse shlyerja ka ndodhur kur pasqyrat financiare janë të autorizuara për lëshim.

Kuptimi i termit 'shlyerje'

Shlyerja me anë të instrumenteve të kapitalit të vet njësisë ekonomike konsiderohet shlyerje për qëllim të klasifikimit të detyrimeve si korente ose jo-korente, me një përjashtim. Në rastet kur një opsjon shndërrimi klasifikohet si një detyrim ose pjesë e një detyrimi, transferimi i instrumenteve të kapitalit neto do të përbënte shlyerjen e pasivit me qëllim të klasifikimit të tij si aktual ose jo-aktual. Vetëm nëse vetë opsioni i konvertimit klasifikohet si një instrument i kapitalit neto, shlyerja me anë të instrumenteve të kapitalit të vet nuk do të merret parasysh kur përcaktohet nëse detyrimi është aktual ose jo rrjedhës. E pandryshuar nga standardi aktual, një qarkullim i huamarrjes konsiderohet zgjatje e një detyrimi ekzistues dhe për këtë arsye nuk konsiderohet të përfaqësojë 'shlyerje'.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

a) Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë entitete të kontrolluara nga Shoqëria. Kontrolli ekziston kur Shoqëria ekspozohet ose ka të drejta mbi kthimet variabël nga përfshirja në investim dhe ka aftësinë për të ndikuar në këto kthime përmes fuqisë mbi investimin. Në vlerësimin e kontrollit janë marrë parasysh të drejtat votuese potenciale që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme. Bazuar në mbikëqyrjen lokale dhe kërkesat ligjore, Shoqëria duhet të raportojë si pasqyrat financiare të konsoliduara dhe pasqyrat financiare të veçanta të shoqërisë mëmë. Pasqyrat financiare të veçanta nuk paraqesin veprimtaritë e filialit të saj, por pasqyrat financiare të konsoliduara që janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar janë në dispozicion për përdorim publik. Pasqyrat financiare të veçanta paraqesin investimin në shoqëritë e kontrolluara me metodën e kapitalit.

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit.

b) Transaksione në monedhë të huaj

Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës.

Normat e këmbimit valutor (Lekë ndaj monedhave të huaja) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
USD	107.05	106.54
EUR	114.23	120.76

Ndërsa kurset mesatare vjetore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 të konvertuar në Lekë janë si më poshtë:

	2022	2021
USD	113.15	103.54
EUR	118.92	122.44

c) Interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha tarifat dhe shumat e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë bilancit të një mjeti apo detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përfshijnë interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuara me normë interesi efektive. Të ardhurat nga interesat nuk njihen për huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve të cilët nuk janë kontaktuar dhe ri-skeduluar në mënyrë të përshtatshme. Interesi paraqitet neto nga çdo rregullim në vlerën kontabël të detyrimit të blerë si rezultat i ndryshimeve në flukset e rrjedhës së parasë.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

d) Të ardhurat

Të ardhurat përfaqësojnë kryesisht të ardhurat që rrjedhin nga portofolet e kredive të blera dhe tarifrat e arkëtueshme nga shërbimi i mbledhjes së kredive për llogari të palëve të treta. Të ardhurat e marra nga portofolet e huave të blera përfaqësojnë kthimin për rrezikun e kredisë, të rregulluar për ndryshimet në vlerat aktuale të portofoleve të kredive që vijnë nga ndryshimet periodike në vlerësimet e flukseve të ardhshme të parave. Tarifrat e shërbimit nga mbledhja e kredive për palët e treta nga Shoqëria, njihen kur përmbushen detyrimet e performancës.

e) Qiratë

(i) Shoqëria si qiramarrëse

Shoqëria nënshkruan marrëveshje qiraje, kryesisht për ambientet ku zhvillohet aktiviteti, pajisjet dhe mobiliet e lidhura me to, pajisjeve IT dhe automjeteve motorike (megjithëse aktualisht Shoqëria nuk përdor automjete me qira).

Kontratat e qirasë negociohen zakonisht për një kohëzgjatje ndërmjet 1 dhe 5 vjetëve dhe disa prej tyre kanë opsionin e zgjatjes së kohëzgjatjes së kontratës. Shoqëria nuk hyn në marrëveshje të shitjes dhe kthimit të objekteve të marra me qira. Të gjitha qiratë janë negociuar mbi baza individuale dhe përmbajnë një larmi të gjerë të termave dhe kushteve të tilla si; termat e pagesës, mbylljes së kontratës dhe klauzolat e përshkallëzimit.

Shoqëria vlerëson nëse ekziston një kontratë qiraje apo nëse një kontratë aktive përmban një qira në përbërjen e saj. Një qira përcjell të drejtën për të përdorur një aktiv dhe për të marrë të gjitha përfitimet ekonomike të këtij aktivi për një periudhë të caktuar kohore, në këmbim të vlerësimit. Disa kontrata qiraje mund të përmbajnë komponentë qiraje ashtu dhe jo qiraje. Këto komponentë jo të lidhura me qiranë, zakonisht lidhen me shërbimet e menaxhimit të pajisjeve të zyrës si edhe kontratat e servisit dhe riparimit të automjeteve motorike. Shoqëria ka zgjedhur të mos i ndajë komponentët e një kontratë qiraje por këto kontrata llogariten si një komponent i vetëm i qiramarrjes. Për qiratë e tjera të saj, përbërësit e qirasë ndahen në komponentët e qirasë dhe jo të qirasë bazuar në çmimet e tyre relative të pavarura.

Matja dhe njohja e qirave nga qiramarrësi

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njeh një të drejtë përdorimi të aktivitetit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar. E drejta e përdorimit të aktivitetit matet me kosto, i cili përbëhet nga: matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga Shoqëria, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të kohëzgjatjes së qirasë dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo pagesë/zbritje e marrë). Shoqëria zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivitetit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në fund të jetës së dobishme të aktivitetit. Shoqëria gjithashtu vlerëson të drejtën e përdorimit të aktivitetit për qëllime të zhvlerësimit, kur tregues të tillë ekzistojnë.

Në datën e fillimit, Shoqëria mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, të zbritura duke përdorur normën e borxhit të Shoqërisë ose normën mesatare të tregut të qiradhënies. Norma e borxhit është norma e vlerësuar që Shoqëria do të duhej të paguante për të marrë hua të njëjtën shumë për një njëjtin afat, për të përfituar një aktiv me një vlerë ekuivalente me atë të marrë me qira. Kjo normë rregullohet nëse njësia ekonomike e qiradhënësit ka një profil rreziku të ndryshëm në krahasim me atë të Shoqërisë. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse, pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shumat që priten të paguhen nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që dalin nga opsionet të arsyeshme dhe të sigurta për t'u ushtruar.

Pas matjes fillestare, detyrimi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që janë alokuar ndërmjet ripagimeve të principalit dhe shpenzimeve financiare. Shpenzimet financiare përfaqësojnë shumat që prodhojnë një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

e) Qiratë (vazhdim)

(i) Shoqëria si qiramarrëse (vazhdim)

Detyrimi i qirasë rivlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e qirasë. Këto ndryshime vijnë nga një ndryshim në afatin e qirasë ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë një aktiv me qira. Pagesat e rishikuara të qirasë zbriten duke përdorur normën e borxhit të Shoqërisë në datën e rivlerësimit, kur norma e nënkuptuar në qira nuk është e mundur të përcaktohet. Shuma e rimatjes së detyrimit të qirasë pasqyrohet si rregullim i vlerës kontabël të së drejtës së përdorimit të aktivitetit. Përfundimisht është kur vlera kontabël neto e së drejtës së përdorimit është reduktuar në zero dhe çdo tepriçë njihet në fitim ose humbje.

Pagesat nën qira mund të ndryshojnë gjithashtu kur ka ose një ndryshim në shumat që priten të paguhet nën garancitë e vlerës së mbetur ose kur pagesat e ardhshme ndryshojnë përmes një indeksi ose normë të përdorur për të përcaktuar ato pagesa, përfshirë ndryshimet në normat e qirasë në treg pas një rishikimi të tregut të qirasë. Detyrimi i qirasë rimatet vetëm kur rregullimi i pagesave të qirasë ka efekt dhe pagesat e rishikuara kontraktuale për pjesën e mbetur të afatit të qirasë zbriten, duke përdorur një normë skontimi të pandryshuar. Përfundimisht rastet kur ndryshimi në pagesat e qirasë rezulton nga ndryshimi i normave të interesit të ndryshueshme, rast në të cilin norma e skontimit ndryshohet për të pasqyruar dhe ndryshimin në normat e interesit.

Për t'iu përgjigjur nevojave të biznesit veçanërisht në kërkesën për hapësirë për zyra, Shoqëria do të hyjë në të negociata me pronarët për të rritur ose ulur hapësirën e disponueshme për zyra ose për të rinegociuar shumat e pagueshme sipas qirave përkatëse. Në disa raste, Shoqëria është në gjendje të rrisë kapacitetin e zyrës, duke marrë në dispozicion hapësira shtesë të lira dhe duke rënë dakord me qiradhënësin për të paguar një shumë që është në përpjesëtim me çmimet e secilës për të pasqyruar kushtet përkatëse të kontratës. Në këto situata, marrëveshja kontraktuale trajtohet si një qira e re dhe llogariten në përputhje me rrethanat.

Në raste të tjera, Shoqëria është në gjendje të negociojë një ndryshim të një kontrate qiraje, si uljen e shumës së hapësirës për zyra, zvogëlimin e afatit të qirasë ose zvogëlimin e shumës totale të pagueshme për qiranë. Këto komponentë nuk ishin pjesë e kushteve origjinale të qirasë. Në këto situata, Shoqëria nuk i konsideron këto komponentë si ndryshime, por i trajton si një kontratë e re qiraje.

Matja dhe njohja e qirave nga qiramarrësi

Në vend të kësaj, pagesat e rishikuara kontraktuale skontohen duke përdorur një normë të rishikuar të skontimit në datën kur qiraja modifikohet në mënyrë efektive. Për arsyt e shpjeguara më sipër, norma e skontimit është norma e borxhit të Shoqërisë e përcaktuar në datën e modifikimit, pasi norma e nënkuptuar në qira nuk është e lehtë për t'u përcaktuar. Ri-matja e detyrimit të qirasë sjell një zvogëlim të vlerës kontabël të aktivitetit me të drejtë përdorimi, për të pasqyruar përfundimin e plotë ose të pjesshëm të qirasë për ato modifikime të saj që zvogëlojnë fushëveprimin e qirasë. Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. E drejta e përdorimit të aktivitetit rivlerësohet për të pasqyruar të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Shoqëria ka zgjedhur të aplikojë përjashtimin për qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur qëllimet praktike. Këto qira kanë të bëjnë me sendet e pajisjeve të zyrës si tavolina, karrige dhe pajisje të caktuara IT. Në vend që të njohin një aktiv me të drejtë përdorimit dhe një detyrim qiraje, pagesat në lidhje me këto qira njihen si një shpenzim periudhe në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) Shoqëria si qiradhënëse

Si qiradhënëse Shoqëria klasifikon qiratë e tij si qira operative ose financiare. Një qira klasifikohet si një qira financiare nëse i transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet tek qiramarrësi.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zërat e kapitalit, e cila njihet direkt në kapital ose në të ardhurat gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare të veçanta, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin statutor përpara taksave për të ardhura dhe shpenzime të caktuara siç kërkohet nga ligji shqiptar.

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit, të cilat pritet të aplikohen në diferencat e përkohshme kur ato realizohen bazuar në ligjet të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit.

Aktivet për tatimet e shtyra njihen në atë pikë ku është e mundur, që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme kundrejt të cilit, aktivi mund të përdoret. Aktivet për tatimet e shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe ulen në atë masë që nuk është e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

g) Aktivet dhe detyrimet financiare

i) Huatë dhe paradhëniet për bankat, huatë dhe paradhëniet për klientët

Shoqëria vlerëson huatë dhe paradhëniet për bankat, klientët dhe investime të tjera financiare vetëm me kosto të amortizuara në qoftë se të dy kushtet e mëposhtme plotësohen:

- Aktivet financiare mbahen me një modeli biznesi me qëllimin për të mbledhur flukse monetare kontraktuale
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin në datat e specifikuara flukse monetare të cilat përbëhen vetëm nga pagesa e principalit dhe interesat për shumën e papaguar të tij.

Detajet e këtyre kushteve përshkruhen më poshtë.

Përcaktimi i modelit të biznesit

Shoqëria përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që reflekton më mirë mënyrën se si menaxhon grupet e aktiveve financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit. Modeli i biznesit i Shoqërisë nuk vlerësohet bazuar në instrumente individuale, por në portofole të grupuara. Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenarët në "rastin e stresit".

Nëse flukset e mjeteve monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritshmëritë fillestare të Shoqërisë, Shoqëria nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin informacion të tillë gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të sapo origjinuara ose ato të blera në vazhdim.

Testi SPPI

Si një hap i dytë i procesit të klasifikimit, Shoqëria vlerëson kushtet kontraktuale të aktiveve financiare për të identifikuar nëse ata përmbushin testin SPPI. "Principalit" për qëllim të këtij testi përcaktohet si vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare dhe mund të ndryshojë gjatë jetës së aktivitetit financiar (për shembull, nëse ka shlyerje të principalit ose amortizimin e primit / skontos).

Elementët më të rëndësishëm të interesit në kuadër të marrëveshjes së huadhënies janë zakonisht konsiderata për vlerën kohore të parasë dhe rrezikut të kredisë. Për të bërë vlerësimin SPPI, Shoqëria zbaton gjykimin dhe shqyrton faktorët relevante si monedha në të cilën është shprehur aktivi financiar dhe periudha për të cilën është përcaktuar norma e interesit.

Në të kundërt, kushtet kontraktuale që paraqesin një ekspozim më pak se minimumi ndaj rreziqeve ose paqëndrueshmëri në flukset monetare kontraktuale që nuk kane lidhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, nuk krijojnë flukse kontraktuale të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit mbi tepricën e huasë. Në raste të tilla, aktivi financiar duhet të matet në VDFH.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

i) *Huatë dhe paradhëniet për bankat, huatë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)*

Në njohjen fillestare, portofolet e blera të kredisë (që përfshijnë kredi dhe të arkëtueshme) njihen me vlerën e drejtë, duke qenë vlera e drejtë e vlerës së paguar ose e pagueshme, plus kostot e transaksionit që mund t'i atribuohen drejtpërdrejt. Rendimenti fillestar rrjedh duke përcaktuar normën që aktualizon arkëtimet e pritshme të parave nga portofoli në vlerën kontabël të njohjes fillestare.

ii) *Njohja*

Shoqëria fillimisht i njeh huatë dhe paradhëniet në datën e blerjes së tyre me vlerën e drejtë, e cila është çmimi i blerjes. Të gjithë aktivet dhe detyrimet e tjera financiare fillimisht njihen në datën e transaksionit kur Shoqëria bëhet palë e provizionit kontraktual të instrumentit.

iii) *Klasifikimi dhe matjet e mëvonshme*

Kreditë e blera janë përfshirë në klasën e aktiveve financiare pasi modeli i biznesit i Shoqërisë për administrimin e këtyre aktiveve dhe karakteristikat e tyre të fluksit të parave kontraktuale janë në përputhje me këtë trajtim.

Këto aktive përfshihen si aktive afatgjatë, përveç shumës së kapitalit që pritet të realizohet brenda 12 muajve nga data e regjistrimit në bilanc, i cili klasifikohet si një aktiv afatshkurtër (për qëllime të raportimit të rrezikut të likuiditetit).

iv) *Matjet e mëvonshme*

Këto aktive fillimisht njihen me koston, pasi kostoja pasqyron vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni të blerjes dhe më pas matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Fitimet neto nga aktivet financiare paraqiten në pasqyrën e të ardhurave si të ardhura nga interesi neto.

Më pas, vlera kontabël e portofolit rregullohet në vlerën e saj aktuale duke u përditësuar me arkëtimet e pritshme të parave dhe duke i zbritur ato duke me përdorimin e normës fillestare.

v) *Zhvlerësimi*

Vlera kontabël e aktiveve rishikohet vazhdimisht për të siguruar që vlera kontabël të mos jetë zhvlerësuar. Këto aktive zhvlerësohen kolektivisht pasi ato nuk konsiderohen të jenë individualisht të rëndësishme brenda portofolit si dhe ato kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Aktivet financiare zhvlerësohen kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Kur një ngjarje pas datës së bilancit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, kjo ulje reflektohet në pasqyrën e të ardhurave.

vi) *Riklasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare*

Shoqëria nuk i riklasifikon aktivet financiare pas njohjes fillestare përveçse në rrethana të jashtëzakonshme në të cilat Shoqëria blen, heq nga përdorimi ose përfundon një linjë biznesi. Detyrimet financiare nuk riklasifikohen asnjëherë. Shoqëria nuk ka riklasifikuar asnjë nga aktivet apo detyrimet financiare të saj në 2022.

vii) *Çregjistrime nga modifikimet thelbësore të termave dhe kushteve*

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar, të tillë si huaja për një klient, kur termat dhe kushtet janë rinegociuar në atë masë që, në thelb, bëhet një hua e re, me diferencën e njohur si fitim ose humbje nga çregjistrimi, deri në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende. Huatë e reja të njohura klasifikohen si Faza I për qëllimet e matjes së HKP-ve, përveçse kur kredia e re, konsiderohet të jetë POCl.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

vii) Çregjistrime nga modifikimet thelbësore të termave dhe kushteve (vazhdim)

Gjatë vlerësimit nëse do të çregjistrohet një hua për një klient, ndër të tjera, Shoqëria konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi në monedhën e huasë
- Futja e një tipari të instrumentit të kapitalit
- Ndryshimi në kundërparti
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti nuk do të përmbushë më kriterin e SPPI

Nëse modifikimi nuk rezulton në flukse të mjeteve monetare që janë në thelb të ndryshme, modifikimi nuk rezulton në çregjistrim. Bazuar në ndryshimet në flukset e mjeteve monetare të skontuara me NEI fillestar, Shoqëria regjistron një fitim ose humbje modifikimi, në masën e paregjistruar të humbjes nga zhvlerësimi.

Për detyrimet financiare, Shoqëria konsideron një modifikim si të konsiderueshëm bazuar në faktorët kualitativë dhe nëse rezulton në një diferencë ndërmjet vlerës aktuale të skontuar të rregulluar dhe vlerës kontabël të detyrimit financiar prej dhjetë përqind ose më shumë. Për aktivet financiare, vlerësimi bazohet në faktorë cilësorë.

viii) Çregjistrime të tjera përveçse ato nga modifikimet thelbësore

Aktivët financiarë

Një aktiv financiar (ose, kur është e mundur, një pjesë e një aktivi financiar ose pjesë e një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar kanë skaduar. Shoqëria, gjithashtu çregjistron aktivin financiar nëse ka transferuar aktivin financiar si dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim. Shoqëria ka transferuar aktivin financiar nëse dhe vetëm nëse:

- Shoqëria ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi financiar; ose
- Ajo ruan të drejtat për flukset e mjeteve monetare, por ka marrë detyrimin për të paguar plotësisht flukset monetare të marra pa vonesa materiale për një palë të tretë nën një marrëveshje 'kalimtare'.

Marrëveshjet kalimtare janë transaksione ku Shoqëria ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi origjinal"), por merr një detyrim kontraktual për të paguar këto flukse monetare në një ose më shumë njësi ekonomike ("përfituesit eventualë"), kur të tre kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të paguajë shumat për përfituesit eventualë, përveç nëse ka arkëtuar shumën ekuivalente nga aktivi origjinal, duke përjashtuar paradhëniet afatshkurtra me të drejtën për rimarrjen e plotë të shumës së huasë plus interesin e përlogaritur me normat e tregut.
- Shoqëria nuk mund të shesë ose të vendosë si kolateral aktivin fillestar përveçse si siguri për marrësit eventualë.

Shoqëria duhet të dorëzojë çdo fluks parash që mbledh në emër të përfituesve eventualë pa vonesë materiale. Gjithashtu, Shoqëria nuk ka të drejtë të ri-investojë flukse të tilla të parasë, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalente të parasë duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës midis datës së arkëtimit dhe datës së dërgesës së kërkuar për përfituesit eventualë. Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Shoqëria ka transferuar kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit; ose
- Shoqëria nuk ka transferuar as ruajtjet thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit, por ka transferuar kontrollin e aktivitetit.

Shoqëria e konsideron kontrollin të transferuar nëse dhe vetëm nëse transferuesi ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësinë e tij për një palë të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

vii) Çregjistrime të tjera përveçse ato nga modifikimet thelbësore (vazhdim)

Aktivitet financiare (vazhdim)

Nëse Shoqëria as nuk ka transferuar e as nuk mbajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet dhe ka mbajtur kontrollin e aktivitetit, aktiviteti vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Shoqërisë, rast në të cilin, Shoqëria njeht edhe një detyrim lidhur me të. Aktivitetet e transferuara dhe detyrimi i lidhur me të maten në një bazë që reflekton të drejtat dhe detyrimet që Shoqëria ka mbajtur.

Përfshirja e vazhdueshme që merr formën e një garancie mbi aktivitetin e transferuar matet me vlerën më të ulët midis vlerës kontabël fillestare të aktivitetit dhe shumën maksimale të konsideratës që Shoqërisë mund t'i kërkohej të paguajë.

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (ose të dyja) në aktivitetin e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet me vlerën që Shoqërisë t'i kërkohej të paguajë gjatë riblerjes. Në rastin e një kontratë me opsion të shkruar mbi një aktivitet që matet me vlerë të drejtë, masa e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike është e limituar më të voglën e vlerës së drejtë dhe çmimit të ushtrimit të opsionit.

Detyrime financiare

Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimi i lindur prej tij zbatohet, anulohet ose skadon.

Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet me një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë thelbësore, zëvendësimi ose modifikimi i tillë trajtohet si një çregjistrim i detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

ix) *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Vështrim i përgjithshëm i parimeve të HKP

Siç përshkruhet në Shënimin e (i), adoptimi i SNRF 9 ka ndryshuar rrënjësisht metodën e zhvlerësimit të humbjes së kredisë së Shoqërisë duke zëvendësuar metodën e humbjeve të ndodhura sipas SNK 39 me atë të humbjes kreditore të pritshme. Nga 1 janari 2018, Shoqëria ka regjistruar një fond zhvlerësimi për humbjet e pritshme të kredisë për të gjitha huatë dhe aktivitetet e tjera financiare, në këtë pjesë të gjitha të quajtura si 'instrumente financiare'.

Fondi i zhvlerësimit HKP bazohet në humbjet e kredisë që pritet të lindin gjatë jetës së aktivitetit (humbja e pritshme e kredisë për jetë ose AGJHKP), përveç nëse nuk ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, rast në të cilin, fondi bazohet në humbjen e pritur të kredisë në 12 muaj (12mHKP).

HKP 12-mujore është pjesa e AGJHKPs që përfaqëson HKP që rezultojnë nga ato ngjarje dështimi në instrumentet financiare që janë të mundshëm brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Të dy AGJHKP dhe 12mHKP janë llogaritur në baza individuale ose në bazë kolektive, në varësi të natyrës së portofolit të instrumenteve financiare.

Shoqëria ka krijuar një politikë për të kryer një vlerësim, në fund të çdo periudhë raportuese, nëse rreziku i kredisë i një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke marrë parasysh ndryshimin në rrezikun e dështimit që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

ix) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Vështrim i përgjithshëm i parimeve të HKP (vazhdim)

Bazuar në procesin e mësipërm, Shoqëria grumbullon kreditë e saj në Fazën 1, Fazën 2, Fazën 3 dhe POCI, siç përshkruhet më poshtë:

- Faza 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, Shoqëria njih një zhvlerësim në bazë të 12mHKP. Kreditë e Fazës 1 gjithashtu përfshijnë kredi ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 2.
- Faza 2: Kur një kredi ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga krijimi, Shoqëria regjistron një fond për AGJHKP-te. Kreditë e Fazës 2 gjithashtu përfshijnë kredi, ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 3.
- Faza 3: kreditë që konsiderohen të zhvlerësuara plotësisht. Shoqëria regjistron një fond për AGJHKP-të.
- POCI: Aktivet e blera ose të origjinuara të zhvlerësuara ("POCI") janë aktivet financiare që janë të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Aktivet POCI regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një NEI të rregulluar. HKP-të njihen ose rimerren vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritshme të kredisë.

Për aktivet financiare për të cilat Shoqëria nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e të gjithë shumës së mbetur, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e aktivit financiar zvogëlohet. Ky konsiderohet një çregjistrim (i pjesshëm) i aktivit financiar.

Llogaritja e HKP-së

Shoqëria llogarit HKP-të në bazë të tre skenarëve të ponderuar me probabilitet e ndodhjes për të matur mungesat e flukseve të pritshme të arkëtimeve, të skontuara në një përafrim me NEI. Një mungesë e arkëtimeve të pritshme është diferenca midis flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të pritshme dhe atyre që njësia ekonomike pret të arkëtojë.

Mënyra e llogaritjeve HKP është përshkruar më poshtë dhe elementët kryesorë janë si vijon:

- PD – Mundësia e dështimit ("PD") është një vlerësim i mundësisë së dështimit gjatë një horizonti kohor të dhënë. Një dështim mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar gjatë periudhës së vlerësimit, nëse aktiviteti nuk është çregjistruar më parë dhe vazhdon të qëndrojë në portofolin e Shoqërisë.
- EAD – Ekspozimi në Dështim ("EAD") është një vlerësim për ekspozimin në një datë të ardhshme dështimi, duke marrë në konsideratë ndryshimet e pritshme në ekspozim pas datës së raportimit, duke përfshirë parapagimet e principalit dhe interesit, të skeduluar në kontratë apo jo, tërheqjet e pritshme në angazhime për financim të dhëna, dhe interesat nga pagesat e pakryera.
- LGD – Dështimi në humbje ("LGD") është një vlerësim i humbjes që del në rastin kur ndodh një dështim në një kohë të dhënë. Ai bazohet në diferencën midis flukseve kontraktuale të arkëtimeve dhe atyre që huadhënësi pret të arkëtojë.

Për llogaritjen e HKP-ve, Shoqëria konsideron tre skenarë (bazë, optimist dhe pesimist). Secila prej tyre shoqërohet me PD të ndryshme. Kur është e rëndësishme, vlerësimi i skenarëve të shumtë përfshin gjithashtu se si pritet të rikuperohen huatë e papaguara, duke përfshirë dhe mundësinë që huatë do të kurohen dhe vlera e kolateralit ose shuma mund të merret nga shitja e aktivitetit.

Periudha maksimale për të cilën përcaktohen humbjet e kredisë është jeta kontraktuale e një instrumenti financiar, përveç nëse Shoqëria ka të drejtën ligjore ta quajë atë më herët.

Humbjet dhe lëshimet nga zhvlerësimi llogariten dhe shpalosen veçmas nga humbjet ose fitimet e modifikimit që llogariten si një rregullim i vlerës kontabël bruto të aktivit financiar.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

ix) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Llogaritja e HKP-së (vazhdim)

Mekanika e metodës HKP është përmbledhur më poshtë:

- Faza 1: 12mHKP llogaritet si pjesë e AGJHKP-ve që përfaqësojnë HKP-të që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Shoqëria llogarit fondin e 12mHKP bazuar në pritshmërinë e një mospagimi që ndodh në 12 muajt pas datës së raportimit. Këto probabilitete të dështimit të pritur 12-mujor aplikohen mbi një EAD të parashikuar dhe shumëzohen me LGD-në e pritshme dhe të skontuar me një NEI të përafërsuar me origjinalin. Kjo llogaritje bëhet për secilin nga tre skenarët, siç është shpjeguar më sipër.
- Faza 2: Kur një hua ka shfaqur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi i saj, Shoqëria regjistron një fond për AGJHKP. Mekanika është e ngjashme me ato të shpjeguara më sipër, duke përfshirë përdorimin e skenarëve të shumtë, por PD-të vlerësohen gjatë gjithë jetës së instrumentit. Mungesat e arkëtimeve të pritura të parave skontohen me një përafërsim të NEI-t original.
- Faza 3: Për kreditë që konsiderohen si të zhvlerësuara, Shoqëria njihet humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës për këto kredi me llogaritje zhvlerësimi individual. Si parim, shumat e provizionit të kredive që zhvlerësohen në baza individuale llogaritet si diferenca ndërmjet shumës së mbetur papaguar të kredisë me a) shumën e kolateralit likuid dhe me b) shumën e vlerës aktuale të të gjitha flukseve monetare të ndryshme të zbritura me normën aktuale të interesit të kredisë.
- Aktivet POCI janë aktive financiare që janë të zhvlerësuara që në njohjen fillestare. Shoqëria njihet vetëm ndryshimet kumulative AGJHKPs që nga njohja fillestare, bazuar në skenarë me probabilitete, skontuar nga NEI i rregulluar.

Aktive financiare të blera ose të gjeneruara të zhvlerësuara (POCI)

Për aktivet financiare POCI, Shoqëria njihet vetëm ndryshimet kumulative në AGJHKP që nga njohja fillestare në fondin e humbjeve.

x) Fshirjet

Më përjashtim të fshirjeve të pjesshme, politika e kontabilitetit të Shoqërisë sipas SNRF 9 mbetet e njëjtë me atë të SNK 39. Aktivet financiare fshihen pjesërisht ose tërësisht vetëm kur Shoqëria nuk ka pritshmëri të arsyeshme për të rikuperuar një aktiv financiar në tërësi ose një pjesë të tij. Nëse shumata që duhet të fshihet është më e madhe se fondi i zhvlerësimit të akumuluar, diferenca fillimisht trajtohet si shtesë e këtij fondi, i cili më pas aplikohet ndaj vlerës kontabël bruto. Çdo rimarrje pasuese kreditohet të shpenzimi i humbjeve të kredisë.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

xi) Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare të këtij aktivi nuk janë më të vlefshme, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukset monetare mbi aktivin nëpërmjet një transaksioni që transferon në mënyrë thelbësore të gjitha risqet dhe përfitimet nga pronësia mbi aktivin financiar. Çdo interes mbi aktivet e transferuara i krijuar apo i mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv apo detyrim i veçantë.

Shoqëria çregjistron detyrimet financiare nëse detyrimet e detajuara në kontratë përfundojnë, janë shlyer ose janë anuluar. Shoqëria merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin e transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen nga bilanci.

Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha rreziqet dhe përfitimet përfshin, për shembull, huadhënien dhe riblerjen e letrave me vlerë.

Kur aktivet u shitën një pale të tretë, me një të ardhur të caktuar nga kontrata e shkëmbimit, transaksioni kontabilizohet si një transaksion financiar i siguruar, i ngjashëm me transaksionet e riblerjes. Transaksionet, në të cilat Shoqëria as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e lidhur me aktivin financiar, e çregjistron aktivin nëse humbet kontrollin mbi të.

Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura gjatë transferimit njihen më vete si aktive ose detyrime sipas rastit. Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli, Shoqëria vazhdon ta njohë aktivin deri në momentin e përfshirjes së saj, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar. Në disa transaksione, Shoqëria mban të drejtat për të marrë ose kryen shërbime për një aktiv financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar çregjistrohet në tërësi nëqoftëse ai i përmbush kriteret e çregjistrimit. Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat për shërbimin, në qoftë se tarifa e shërbimit është më e lartë se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

xii) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Shoqërisë.

xiii) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

xiv) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e kuotuar të tregut ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumente financiare të tregtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentet e tjera financiare vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumente të tjera të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe modele vlerësimi.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

xiv) Matja me vlerë të drejtë (vazhdim)

Për këto instrumente financiare, inputet në modele janë të vëzhgueshme në treg, nëse ka. Për instrumente më komplekse, Shoqëria përdor modele vetjake, të cilat zakonisht zhvillohen nga modele të njohura të vlerësimit. Disa ose të gjitha inputet në këto modele mund të mos jenë të vëzhguara nga tregu dhe rrjedhin nga çmimet ose tarifat e tregut ose vlerësohen bazuar në supozime. Kur hyni në një transaksion, instrumenti financiar njihet fillimisht me çmimin e transaksionit, që është treguesi më i mirë i vlerës së drejtë, megjithëse vlera e marrë nga modeli i vlerësimit mund të ndryshojë nga çmimi i transaksionit. Ky ndryshim fillestar në vlerën e drejtë të treguar nga teknikat e vlerësimit njihet në të ardhura ose shpenzime në varësi të fakteve dhe rrethanave individuale të secilit transaksion dhe jo më vonë se kur të dhënat e tregut bëhen të vëzhgueshme.

Vlera e nxjerrë nga një model ose nga teknikat e vlerësimit rregullohet me një numër të caktuar faktorësh më të përshtatshëm, sepse teknikat e vlerësimit nuk mund të reflektojnë siç duhet të gjithë faktorët e tregut që merren parasysh në një transaksion. Rregullimet e vlerësimit përdoren për të përshtatur modelet me rrezikun, marzhin kërkesë-ofertë, rrezikun e likuiditetit si edhe faktorë të tjerë. Drejtimi beson se këto rregullime vlerësimi janë të nevojshme dhe të përshtatshme për të paraqitur me vlerë të drejtë instrumentat financiarë. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë është vlerësuar të jetë me përafërsi e barabartë me vlerën kontabël.

xv) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes, janë zhvlerësuar.

Aktivët financiarë zhvlerësohen kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

financiare që kanë një vlerë të konsiderueshme në mënyrë individuale, testohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha aktivët e testuar individualisht dhe jo të zhvlerësuar, grupohen dhe testohen për ndonjë zhvlerësim të ndodhur por të paidentifikuar ende. Aktivët të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshëm trajtohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku. Aktivët financiarë si hua dhe paradhënie ndaj klientëve, të cilat janë pjesë e portofolit të kredive dhe nuk janë skeduar akoma, nuk zhvlerësohen mbi bazën e flukseve të pritshme të ardhshme të parave që do të përfitonte Shoqëria.

Si evidencë objektive që aktivët financiarë janë të zhvlerësuar mund të përfshihen vonesa në pagim ose shkelje nga huamarrësit, ristrukturimi i termave të një huaje ose paradhënie në kushte të pafavorshme për Shoqërinë, të dhëna që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktive si p.sh. ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të huamarrësve ose huadhënësve të grupit ose kushte ekonomike që tregojnë për mospagime.

Për trajtimin e zhvlerësimit në grup, Shoqëria përdor modelimin statistikor të trendëve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Probabiliteti i mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rikuperimit krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme. Humbjet nga zhvlerësimi të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve dhe pasqyrohen në një llogari fondi për humbjet nga zhvlerësimi përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivët e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimit. Kur një ngjarje pas datës së bilancit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, kjo ulje reflektohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

h) Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to

Aktive monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë kartëmonedha, monedha, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Shoqëria për administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivet monetare dhe ekuivalente me to mbahen me koston e amortizuar.

i) Investime në filiale

Investimet në filiale janë të klasifikuara si aktive financiare të mbajtura për shitje dhe janë njohur me kosto, pasi vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme për shkak të informacionit të disponueshëm të vlerës së tij të drejtë. Pas njohjes fillestare, ato maten me koston neto të, nëse ka, humbje nga zhvlerësimi.

j) Huatë

Huatë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Huamarrjet përmbajnë kushte, të cilat nëse tejkalohe do të bëjë huamarrjet ripagueshme sipas kërkesës dhe të klasifikuara si detyrime afatshkurtra.

k) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kostot përfshijnë shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme në blerjen e mjetit. Kosto e aktiveve të vetë ndërtuara përfshijnë koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi, dhe kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe kthimit të vendndodhjes në kushtet e duhura. Blerja e programeve kompjuterike si pjesë integrale e funksionimit të mjetit, kapitalizohet si pjesë e këtij mjeti. Kur pjesë të mjeteve apo pajisjeve kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçanta të aktiveve të qëndrueshme materiale.

(ii) Kosto vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të mjetit apo pajisjeve njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin të Shoqëria, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje me anën e metodës zbritëse mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivit. Aktivet e marra me qira zhvlerësohen në periudhën më të shkurtër midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Normat e zhvlerësimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si vijon:

Kompjuterat	4 vjet
Mobilje dhe pajisje	5 vjet
Makina	5 vjet

Metoda e zhvlerësimit dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit.

(i) Programet kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Shoqëria kontabilizohen me koston minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen si të tilla në periudhën që ndodhin. Shpenzimi i amortizimit njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është pesë vjet.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

l) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbjet nga rënia në vlerë njihen nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

m) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para tatimit, e cila reflekton vlerën e tregut, dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Shoqëria miraton një plan ristrukturimi të detajuar dhe kur ristrukturimi ka filluar ose është shpallur zyrtarisht. Kosto të tjera operimi nuk mbulohen.

Një provizion për kontrata të këqija njihet kur përfitimet e pritura nga kontrata për Shoqërinë janë më të vogla se kostot e pashmangshme për përmbyshjen e detyrimeve sipas termave të kontratës. Provizioni matet me vlerën më të vogël midis kostos së mbylljes së kontratës dhe kostos së pritjes neto e vazhdimit të kontratës. Para se të vendoset një provizion, Shoqëria njihet nga zhvlerësimi i aktiveve të lidhura me kontratën.

n) Përfitimet e punonjësve

i) Kontributet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet sipas një plani kontributësh të përcaktuar për pensione. Kontributet për planin e pensionit që bën Shoqëria pasqyrohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

ii) Leja vjetore e paguar

Shoqëria njihet si detyrim shumë e skontuar të kostove të vlerësuara për lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të periudhës së shërbimit të kryer të punonjësit.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

a) Hyrje dhe të përgjithshme

Përdorimi i instrumenteve financiarë e ekspozon Shoqërinë ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Shoqërisë.

Struktura e administrimit të rrezikut

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar përputhjen me kufizimet. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve, standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare i Shoqërisë nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet klientëve, bankave dhe investimi në letra me vlerë. Për qëllime të administrimit të rrezikut të kredisë, Shoqëria konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si rreziku që rrjedh nga vetë klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori).

Vlera e mbetur e aktiveve financiare përfaqëson maksimumin e ekspozimit të rrezikut të kredisë.

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	92,714,028	150,331,329
Hua dhe parapagime ndaj klientëve	142,491,723	127,476,634
Totali	235,205,751	277,807,963

Rreziku i kredisë në lidhje me kreditë e blera menaxhohet nëpërmjet përcaktimit të çmimit fillestar të blerjes për një portofol me kredi të këqija. Pas blerjes, kreditë fillimisht njihen me vlerën e drejtë në nivel portofoli, i cili është çmimi i transaksionit dhe më pas me kosto të amortizuar, duke zbritur zhvlerësimin. Shumica e aktiveve, për nga natyra e tyre, janë të zhvlerësuar që në blerje, e cila reflektohet në vlerën e drejtë. Kostoja e amortizuar matet si vlera aktuale e së ardhmes së parashikuar të flukseve monetare duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Norma efektive e interesit të rregulluar nga kredia llogaritet në njohjen fillestare dhe pasqyron një kthim periodik të vazhdueshëm të vlerës së mbartur të kredive.

Drejtimi monitoron në mënyrë të vazhdueshme flukset e parave dhe vlerën kontabël të aktiveve të blera. Zhvlerësim i kredive të blera vlerësohet rregullisht nga drejtimi dhe identifikohet në bazë portofoli duke u bazuar në evidenca. Një zhvlerësim njihet kur performanca aktuale dhe ri-parashikimi i fluksit të parave të ardhshme devijojnë nën normën fillestare efektive të interesit. Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022, zhvlerësime shtesë u njohën në krahasim me 1 Janar 2022, pasi flukset e vlerësuar të ardhshme të parasë ndryshojnë nga flukset fillestare të parave të pritura (me një normë nën normën fillestare efektive të interesit). Të gjitha të ardhurat nga rikuperimi i këtyre aktiveve njihen si interes, duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Rreziku i vazhdueshëm i kredisë menaxhohet përmes aplikimit të një modeli, i cili parashikon rikuperueshmërinë bazuar në sjelljen historike të kredisë, bazuar në specifika të tilla si lloji i borxhit, vitet e rikuperimit dhe lloji i marrëveshjes së arritur me klientët.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Shoqëria nuk ka përqendrim të konsiderueshëm të rrezikut të kredisë tregtare. Shoqëria ka politika për shërbime që iu bëhen klientëve me historik krediti të mirë. Shoqëria përcakton një fond për zhvlerësimin që përfaqëson parashikimin e saj për humbjet nga llogaritë e arkëtueshme.

Rreziku i përqendrimin të rrezikut të kredisë së klientit është i kufizuar për shkak të numrit të lartë të klientëve individualë dhe vlerës relativisht të ulët të borxheve të secilit individ.

Hua dhe parapagime ndaj klientëve	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Numri i llogarive të klientëve	107,059	99,167
Balanca mesatare për llogari	1,331	1,285

Shoqëria zhvillon dhe ruan klasifikimin e rrezikut, në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin sipas shkallës së rrezikut që paraqitet për humbjet financiare, si dhe me qëllim fokusimin e drejtimit drejt rrezikut të pritshëm. Sistemi i klasifikimit të riskut përdoret për përcaktimin e rasteve kur kërkohet provigjonimi i zhvlerësimeve për ekspozime specifike kredie.

Kuadri aktual i klasifikimit të riskut konsiston në 5 kategori, në përputhje me Rregulloren e Shoqërisë së Shqipërisë për Administrimin e Rrezikut të Kredisë, duke reflektuar shkallë të ndryshme risku, disponueshmëri të kolateralit dhe zbutje të tjera të rrezikut të kredisë. Shkallët e riskut janë subjekt i monitorimit të rregullt mujor.

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë pagesën e angazhimeve që lindin nga detyrimet financiare.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i Shoqërisë në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikojë të dëmtojë emrin e mirë.

Tranzit sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Shumat janë në Lekë, përveçse kur specifikohet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Maturiteti kontraktual i mbetur i aktiveve dhe detyrimeve financiare

